



REPUBLIKA E SHQIPËRI
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800839/11

Tiranë ___/___/2018

Lënda: *Për fillimin e procedurës administrative për marrjen e masës disiplinore.*

Marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit sikurse përcaktuar në shkresën nr.K3/M19-2 Prot, datë 17.05.2018, drejtuar Regjistruesit të ZVRPP Pogradec.

Drejtuar : **Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**
Z. Valdrin Pjetri

TIRANE

Për dijani : **Sekretarit të Përgjithshëm**
Pranë : Ministrisë së Drejtësisë

TIRANE

Z. Pjetri!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka në shqyrtim ankesën e shtetasit M.M., me banim në Fshatin Çërravë, Pogradec. Ai ankohet e pretendon mosdhënien e shërbimit të kërkuar për lëshimin e akteve të pronësisë për pasurinë e tij, banesë e ndërtuar në Vitin 1988, dhe rregjistruar në rregjistrin e pasurive të paluajtshme të ZVRPP, Pogradec, me nr.293/39, Vol 5, Faqe 11, ZK 1387, Fshati Çërravë.

Për të mundësuar zgjidhjen e kësaj çështjeje ne, në mënyrë të përsëritur, kemi kërkuar ZVRPP, Pogradec, informacion dhe shpjegime rreth shkaqeve të cilat justifikojnë moslëshimin e dokumentacionit të pronësisë ankuesit, konform aplikimit të kryer prej tij nr.3963-3977, datë 24.09.2009.

Faktet :

- Me shkresat nr.K3/M19-2 Prot, datë 17.05.2018, nr.K3/ M19-4 Prot, datë 18.06.2018, nr.K3/ M19-6 Prot, datë 23.07.2018, nr.K3/ M19-8 Prot, datë 23.08.2018, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar ZVRPP, Pogradec, informacion dhe shpjegime rreth çështjes të lartpërmendur.
- Përkundër kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, Kryeregjistruesi i ZQRPP, me shkresat nr. 5368/1 Prot, datë 03.07.2018, nr.5368/4 Prot, datë 27.08.2018, dhe nr.5368/5 Prot, datë 14.09.2018, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.8321/1 Prot, datë 03.08.2018, kanë tërhequr vëmendjen si dhe kërkuar përmbushjen e detyrimit ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Pa shkak të bërë të ditur, ZVRPP, Pogradec, nuk ka përmbushur në afat detyrimin ligjor si dhe nuk përmbush detyrimin për dhënien e informacionit të kërkuar, konform parashikimit të kryer në nenin 63/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 19 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar.

Edhe pse ju z.Kryeregjistrues, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë keni reaguar për ndryshimin e situatës së parregullt të krijuar nga veprimtaria e punonjësve të ZVRPP, Pogradec, nuk është shprehur deri më sot asnjë qëndrim zyrtar apo verbal, prej Regjistruesit të ZVRPP, Pogradec, në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të rregullt e të ligjshme.

Përkundër kësaj suate, si më sipër prezantuar, qëndrimi i punonjësve të ZVRPP, Pogradec, është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efikasitetit, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të Ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 1 të këtij Kodi.

Qëndrimi i mbajtur prej Regjistruesit të ZVRPP, Pogradec, në procesin e trajtimit të aplikimit të kryer prej ankuesit ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për lëshimin e dokumenteve të pronësisë, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Qëndrimin e derisotëm të mbajtur nga ana Regjistruesit të ZVRPP, Pogradec, e vlerësojmë në cënim të së drejtës së pronësisë, parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar respektivisht në nenin 41, 42/2 të Kushtetutës, nenin 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës, si rrjedhojë e mosdhënies së shpjegimeve dhe informacionit të kërkuar apo dhe mosmarrjes së masave në afatin e vendosur për lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit ankues.

Përpos situatës së prezantuar, konstatohet se, Regjistruesi i ZVRPP, Pogradec, nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit, duke u bërë në këtë mënyrë pengesë në ushtrimin e detyrës kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga

veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efçente dhe në një afat sa më të arsyeshëm

Për arsyet e bëra të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se; “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”, si dhe nenit 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDOJMË

Fillimin e procedurës administrative për dhënie mase disiplinore ndaj punonjësit të ZVRPP Pogradec, i cili do të rezultoj në shkelje të detyrimit për lëshimin e dokumentacionit të pronësisë në favor të subjektit ankues, si dhe dhënies së informacionit të kërkuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit.

Marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit sikurse përcaktuar në shkresën nr.K3/M19-2 Prot, datë 17.05.2018, drejtuar Regjistruesisit të ZVRPP Pogradec.

Në përputhje me parashikimin e kryer në nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën, apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës, apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh, apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

kthimi i përgjigjes nga ana juaj duhet të kryhet në afatin ligjor të përcaktuar dhe duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh, apo masash ka ndërmarrë ai organ.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Kopje të shkresave nr.K3/M19-2 Prot, datë 17.05.2018, nr.K3/ M19-4 Prot, datë 18.06.2018, nr.K3/ M19-6 Prot, datë 23.07.2018, nr.K3/ M19-8 Prot, datë 23.08.2018,, të Institucionit të Avokatit të Popullit drejtuar Regjistruesisit të ZVRPP, Pogradec.

Kopje të shkresave nr. 5368/1 Prot, datë 03.07.2018, nr.5368/4 Prot, datë 27.08.2018, dhe nr.5368/5 Prot, datë 14.09.2018, të Kryeregjistruesisit të ZQRPP, drejtuar Avokatin e Popullit.

Kopje të shkresave nr.8321/1 Prot, datë 03.08.2018, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Avokatin e Popullit.

Kopje të ka vendosur me Vendimin Gjyqësor Civil të formë së prerë nr.1328, datë 21.12.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Pogradec.

Kopje të aplikimit nr.3963-3977, datë 24.09.2009, kryer prej ankuesit pranë ZVRPP, Pogradec.

*Kopje të Plan Rilevimit për pasurinë 240/26, vol 2, faqe 27, përgatitur prej z. B.Z..
Kopje e kartelës së pasurisë së paluajtshme nr.240/26, vol 2, faqe 27, ZK 1387, ndodhur
në Fashit Çërravë, Pogradec.
Kopje të printimit të tretë për pasurinë 240/26, vol 2, faqe 27.*

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**